

Si të përditësoni telefonin tuaj Android

Versioni 10-sekondësh


1. Hapni aplikacionin e **Settings**.
2. Klikoni **About device** në fund të menisë.
3. Klikoni **System updates**.
4. Klikoni **Check for update**.
5. Klikoni **Download** nëse shfaqet një përditësim.
6. Klikoni **Install** pasi të ketë përfunduar shkarkimi i përditësimit.

Metoda 1

Kërkimi për Përditësim të Sistemit



1. Hapni Menunë “Settings” për Android-in tuaj. Këtë mund t’ a gjeni duke klikuar aplikacionin “Settings” në Listën e Aplikacioneve.




2. **Zbrisni në fund të menisë dhe klikoni About device**. Mund të jetë edhe “About phone” ose “About tablet” në varësi të llojit të pajisjes që po përdorni.

- Nëse nuk e gjeni butonin “About device”, klikoni në fillim kategorinë “System”.
- Në disa pajisje Android, do të shikoni opsionin “System updates” në menunë kryesore të Settings poshtë “About device”. Kliko këtë buton, në këtë rast.




3. **Klikoni System updates**. Mund të jetë edhe “Software updates” ose “Download updates manually”.




4. **Klikoni Check for update**. Formulimi mund të ndryshojë në varësi të pajisjes tuaj.
5. **Klikoni OK**, nëse ju kërkohet konfirmim.

6. Prisni ndërkohë që pajisja juaj kontrollon për përditësime. Kjo mund të zgjasë disa momente.



7. Klikoni **Download** ose **Yes**, nëse shfaqet një përditësim. Përditësimi do të fillojë të shkarkohet në pajisjen tuaj. Rekomandohet që t'i shkarkoni përditësimet ndërkohë që jeni lidhur me një rrjet wireless, sepse mund të jenë voluminozë.

- Nëse nuk ka asnjë përditësim, mund të provoni përsëri më vonë. Mbajtja shtypur e butonit “**Check for Update**” nuk ndihmon që përditësimet të shfaqen më shpejt.




8. Klikoni **Install Now** pasi përditësimi të ketë përfunduar së shkarkuari. Mund të duhet pak kohë që përditësimi të shkarkohet apo që opsioni i shkarkimit të bëhet i disponueshëm.

9. Lidhni pajisjen tuaj me karikuesin. Do t'ju duhet të paktën 50% bateri përpara se të filloni një përditësim sistemi, dhe rekomandohet t'a mbani pajisjen në karikim gjatë procesit.

10. Prisni ndërkohë që pajisja përditësohet. Pajisja juaj Android do të rindizet dhe do të fillojë procesin e përditësimit. Ky proces mund të zgjasë 20-30 minuta për të përfunduar.

Metoda 2

Kërkimi për Përditësim të Aplikacioneve

1. Hapni aplikacionin Play Store. Atë mund t'a gjeni në Listën e Aplikacioneve. Ikona duket si një çantë blerjesh me logon e Google Play mbi të.
2. Klikoni butonin . Këtë e gjeni në të majtë lart.
3. Klikoni **My apps & games**.
4. Klikoni **Update All** për të instaluar përditësimet e disponueshme. Ky buton nuk do të shfaqet nëse nuk ka aplikacione me përditësim të disponueshme.
5. Klikoni një aplikacion në listën **Updates**. Nëse preferoni të shikoni detajet e një përditësimi përpara instalimit, atëherë përditësoni çdo aplikacion individualisht.
6. Shikoni zonën **What's New**. Është në dëshirën e krijuesit të aplikacionit të zgjedhë çfarë ndryshimesh listohen aty, por shpesh do të gjeni informacion mbi qëllimin e përdorimit të tij.
7. Klikoni **Update** për të shkarkuar dhe instaluar përditësimin e aplikacionit.


Metoda 3

Imponimi i Kontrollit për Përditësim të Sistemit




1. Hapni tastierën e formuesit të numrave për thirrje në pajisjen tuaj. Në disa telefona, ju mund të impononi një kontroll për përditësime të disponueshme duke përdorur këtë tastierë. Disa përdorues e kanë përdorur me sukses këtë metodë për të gjetur përditësime përpara se pajisja e tyre t'i ketë sinjalizuar ato normalisht.

- Kjo metodë nuk garantohet se funksionon, edhe nëse pajisja juaj është propozuar për një përditësim.
- Kjo metodë nuk gjeneron përditësime, nëse nuk ka të tilla në dispozicion.



2. Formoni * ## # 2 4 3 2 5 4 6 # * # *. Telefoni juaj do të kontrollojë automatikisht për përditësime sapo të shtypni * e fundit.



3. **Shiko për mesazhin “checkin succeeded”**. Ai do të shfaqet në shiritin e Njoftimeve. Kjo do të thotë se lidhja u krye me sukses, por nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka përditësime të disponueshme.

4. **Shkarkoni përditësimin tuaj (nëse ka të tillë)**. Nëse ka përditësim, një mesazh do të shfaqet në ekran me udhëzime mbi mënyrën e fillimit të shkarkimit.

Metoda 4

Përdorimi i butonit Smart për Pajisjet Samsung

1. **Hapni një faqe interneti në kompjuterin tuaj**. Nëse keni telefon Samsung, ju mund të përdorni programin e butonit Smart të Samsung-ut për të kontrolluar për përditësime. Ky program zëvendëson komanduesin e vjetër Samsung Kies të pajisjes.
2. **Vizitoni faqen e internetit [Smart Switch](#)**.
3. **Klikoni linkun [Download for PC](#) ose [Download for Mac](#)**.
4. **Operoni instaluesin e shkarkuar**.
5. **Ndiqni komandat për instalimin e Smart Switch**.
6. **Lidhni pajisjen tuaj Samsung me kompjuterin**.
7. **Klikoni butonin [Update](#) në ekranin e Smart Switch**. Ky buton do të shfaqet poshtë emrit të pajisjes së lidhur në rast se ka ndonjë përditësim të disponueshëm.
 - Nëse nuk ka buton për përditësim, përditësimi nuk është i disponueshëm, nëse mendoni se duhet të ketë një përditësim, ka mundësi që ofruesi është duke krijuar një version që do t'a ofrojë më vonë.
8. **Klikoni [Update](#) në dritaren që shfaqet**. Do të shikoni versionin e ri që do të adoptoni.
9. **Klikoni [OK](#) për të filluar përditësimin**. Pajisja juaj do të fillojë procesin e përditësimit. Mos shtypni asnjë buton në pajisje dhe mos e shkëputni atë nga lidhja derisa përditësimi të ketë përfunduar plotësisht.